

06.07.2026

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E SUHAREKËS OPSTINA SUVA REKA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
	MARRË NË DORËZIM-PRIMIRAN RECEIVED	Shitja Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value	
	Org. Jedinica Org. Unit	Broj Number		
	01	351	30701	2

KONTRATË

Numri i kontratës ¹: 624-26-4629-5-5-8/C1378

KOMUNA SUHAREKË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë dhe **WOOD CORPORATION L.L.C.**, Rr.Ukë Bytyqi, Suharekë, NUI 811289562 të cilën e përfaqson **Naser Gashi** ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Furnizim me inventar per Komunë dhe Shkollë
me numër identifikues: 624-26-4629-5-5-8 & 624-26-35-558

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

1	Furnizim me inventar per Komunë dhe Shkollë
---	---

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë **10 ditë** nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Kontrata hynë në fuqi me **02.07.2026** dhe përfundon pas **6 Muajve**.

2.3 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë **Komuna e Suharekës**.

2.4 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Qmimi total i peshuar i kontratës per njesi është **9,489.40** (nëntë mijë e katerqind e tetëdhjetë e nëntë euro e dyzetë cent).

Vlera e parashikuar e kontratës : 70.000.00 (shtatëdhjetë mijë).

4.2 Pagesa do të bëhet nga ana e Autoritetit Kontraktues për furnizimet e kryera vetëm në bazë të shumës së vlerës së një Urdhër Blerje te vlefshme të lëshuar nga autoriteti kontraktues, e nënshkruar nga Menaxheri i Kontrates me raportin e kryerjs së furnizimit.

4.3 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.4 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

[Nëse disa artikuj iu nënshtrohen ndryshimeve]

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim:

4.5 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;
- (f) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit]*.

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.





6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqip në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Numri kontaktues: +383-45-101-880

Email: info@tenaseri.com

Për Autoritetin Kontraktues

Për Kontraktuesin

Emri:	Fatos Kuqi	Emri:	Naser Gashi
Pozita:	Udhëheqës i Prokurimit	Pozita:	Përfaqësues
Nënshkrimi		Nënshkrimi:	
Data:	02.07.2026	Data:	02.07.2026
Vula:		Vula:	

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 624-26-4629-5-5-8/C1378

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 **"Produktet"** përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.

1.3 **"Autoriteti Kontraktues"** do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tenderit.

1.4 **"Furnizues"** do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 **"Palë(t)"** do të thotë nënshkruesit e kontratës.

1.6 **"Inkotermet"** do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.7 **"Furnizim"** do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

1.8 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohet në formularin e kontratës, në përputhje me shtesa të tilla dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.

1.9 **"Shërbimet pas shitjes"** do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, sigurimi i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe/ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimet e produkteve.

1.10 **"KPK"** do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.11 **"KVK"** do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

- kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
- në rast të dhënies së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Furnizuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Furnizuesi nuk

nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Furnizuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Furnizuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Furnizuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Furnizuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimit final të saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

6.1 Furnizuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënat mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkuara ose licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendosë që të marrë lejet e kërkuara apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe syçeltësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

Neni 8 Prejardhja

8.1 Furnizuesi do të paraqesë një certifikatë zyrtare të prejardhjes në momentin e pranimit të përkohshëm. Nëse ky obligim nuk plotësohet, kjo do të çojë në ndërprerje të kontratës, me paralajmërim zyrtar.

Neni 9 Siguria e ekzekutimit

9.1 Furnizuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.

9.2 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

9.3 Përveç asaj pjese të specifikuar në KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikatës së perkohshme të pranimit.

Neni 10 Sigurimi

10.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jene të siguruara plotësisht me një valute lirisht të konvertueshme kundër humbjes ose dëmtimit të rastësishëm të prodhoj ose blejë, transportoj, ruaj dhe shpërndaj në mënyrën e specifikuar në KVK.

10.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Furnizuesit sipas Nenit 10.1, Furnizuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Furnizuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

Neni 11 Programi i realizimit

11.1 Nëse kërkohet në KVK, Furnizuesi do të dorëzojë një program të realizimit të kontratës që do të aprovohet nga autoriteti kontraktues. Ky program do të përmbajë së paku këto:

- i) rendin sipas të cilit Furnizuesi propozon të realizohet kontrata, duke përfshirë dizajnin, prodhimin, dorëzimin në vend të pranimit, instalimin, testimin dhe komisionimin; dhe
- ii) të dhëna dhe informata të tjera të cilat mund t'i kërkojë me arsye autoriteti kontraktues.

11.2 KVK do të saktësojë limitin kohor brenda të cilit programi i realizimit duhet t'i dorëzohet për aprovim autoriteti kontraktues dhe afatin e fundit për aprovimin e Autoritetit Kontraktues. Aprovimi i programit nga autoriteti kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

11.3 Nëse Autoriteti Kontraktues nuk arrin të njoftoj vendimin e tij të aprovimit të përmendur në Nenin 11.2 brenda afateve të përmendura në kontratë programi i tillë i realizimit duhet të konsiderohet i aprovuar me kalimin e afateve. Në qoftë se nuk ka afat të caktuar, ato do të konsiderohen të aprovuara 30 dite pas pranimit.

11.4 Asnjë ndryshim material në program nuk mund të bëhet pa aprovimin e autoritetit kontraktues. Megjithatë, nëse progresi i realizimit të kontratës nuk bëhet sipas programit, autoriteti kontraktues mund ta udhëzojë Furnizuesin që ta ripunojë programin dhe ta dorëzojë programin e ripunuar për aprovim të ai.

11.5 Para pranimit të perkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi duhet të furnizoj me manualët e funksionimit dhe mirëmbajtjes së bashku me vizatime, të cilat do të jenë në detaje të tilla që do të mundësoj Autoritetit Kontraktues operimin, mirëmbajtjen, rregullimin dhe riparimin e të gjitha pjesëve të furnizimeve. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në KVK, manualët dhe vizatimet do të jenë në gjuhën e kontratës dhe në formë dhe numrat të tilla të deklaruara në kontratë. Furnizimet nuk do të konsiderohen të përfunduara me qëllim të pranimit të perkohshëm deri sa manualët dhe vizatime të tilla janë furnizuar Autoritetit Kontraktues.

Neni 12 Marrëveshjet tatimore dhe doganore

12.1 Duke iu nënshtuar dispozitave të tjera të përcaktuara në KVK, Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për pagesën e të gjitha taksave, detyrimeve të pullës, taksat e licencave, tarifët doganore dhe taksat tjera që lindin apo imponohen deri në dorëzimin e Mallrave të kontraktuara në vendin e dorëzimit, siç është përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 13 Patentat dhe licencat

13.1 Përveç në rastet kur është paraparë ndryshe në KVK, Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

Neni 14 Periudha e ekzekutimit të detyrave

14.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e fiksuar në pajtim me Nenin 2, pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 15.

14.2 Përveç kur palët pajtohen ndryshe, realizimi i kontratës duhet të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Furnizuesi ka të drejtë të mos e realizojë kontratën dhe të marrë përfundimin e saj apo kompensimin për dëmin që ka pësuar. Furnizuesit do ta humbë këtë të drejtë përveç nëse ai e ushtron atë brenda 30 ditëve

nga data e skadimit të periudhës 90 ditësh.

14.3 Nëse mundësohen periudhat e ndara të realizimit për sasi të ndara, këto periudha nuk do të mbliidhen në rastet kur një Furnizuesi i jepen më shumë se një sasi.

Neni 15 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

15.1 Furnizues mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues porosit furnizime ekstra ose plotësuese;
- b) Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;
- c) Pengesa apo kushte fizike që mund të ndikojnë në dorëzimin e furnizimeve, të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- d) Urdhra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përveç atyre që janë shkaktuar prej gabimit të furnizuesit;
- e) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- f) Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të furnizimeve që nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit;
- g) Forca madhore;
- h) Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit.

15.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Furnizues duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

15.3 Brenda 30 ditësh, me njoftim me shkrim për furnizuesin, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 16 Vonesat e ekzekutimit

16.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

16.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 16.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të kontratës

16.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së kontratës ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Furnizuesin:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënie e pjesës së mbetur të furnizimeve. Furnizuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

Neni 17 Suspendimi

17.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhër administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Furnizuesin që të pezullojë:

- a. prodhimin e furnizimeve;
- b. dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimi në kohën e specifikuar për dorëzim në programin e realizimit ose, nëse nuk është specifikuar koha, në kohën kur ato duhet të dorëzohen; ose
- c. instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimi.

17.2 Gjatë pezullimit, Furnizuesi do të mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depon e Furnizuesit ose në ndonjë vend tjetër, nga përkeqësimi, humbja apo dëmtimi për aq sa të jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nëse furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimi në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.

17.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do të marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- a) Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë; ose
- b) është i nevojshëm për arsye të kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimit;
- c) është i nevojshëm për shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- d) është i nevojshëm për siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjese të saj përderisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

17.4 Furnizues nuk do të ketë të drejtë për shtesa në çmimin e kontratës përveç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit për të pezulluar progresin e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë ankesë për ta.

17.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Furnizuesin, do të përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do të bëhen nga Furnizues përkitazi me këtë ankesë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.

17.6 Nëse periudha e pezullimit i tejkalon 180 ditë, dhe pezullimi nuk është për shkak të gabimit të Furnizuesit, Furnizues, duke njoftuar autoritetin kontraktues, mund të kërkojë të vazhdojë me furnizimet brenda 30 ditësh, ose të ndërpresë kontratën.

17.7 Në rastet kur procedura e dhënies ose realizimit të kontratës bëhet e pavlefshme për shkak të gabimeve përmbajtjesore, parregullsive ose mashtrimit, Autoriteti kontraktues do ta pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet kur ato gabime, parregullsi ose mashtrime i atribuohen Furnizuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund të refuzojë t'i bëjë pagesat ose mund t'i kthejë shumat që tashmë janë paguar, në proporcion me rëndësinë e gabimeve, parregullsive ose mashtrimit.

17.8 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që të verifikohet nëse gabimet përmbajtjesore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtrimet kanë ndodhur në të vërtetë. Nëse ato nuk mund të konfirmohen, realizimi i kontratës do të rifillojë sa më shpejt që është e mundur. Gabimet përmbajtjesore ose parregullsitë do të jenë të gjitha shkelje të kontratës ose dispozitave rregullative që rezultojnë nga një veprim ose mosveprim që shkakton ose që mund të shkaktojë humbje në buxhetin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 18 Cilësia e furnizimeve

18.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

18.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet të bëhen me kërkesë të dërguar nga furnizuesi i për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do të saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuara për këtë pranim sipas kontratës dhe të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrën e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në furnizime.

18.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do të inkorporohen në furnizime ose në prodhim të komponentëve që do të furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund të refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet të ndërrohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikujt do të pranohen për inkorporim në furnizime vetëm nëse janë riparuar dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

Neni 19 Inspektimi dhe testimi

19. Furnizues do të sigurojë që furnizimet të dorëzohen në vendin e pranimit me kohë që t'i mundësohet autoritetit kontraktues të vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë.

19.2 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimit apo në vendet që janë specifikuar në KVK.

19.3 Për qëllime të testimeve dhe inspektimeve të tilla, Furnizues do të:

- a) I japë autoritetit kontraktues, përkohësisht dhe pa pagesë, ndihmë, mostra ose pjesë për testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit që zakonisht kërkohen për inspektim dhe testim;
- b) Të merret vesh me autoritetin kontraktues për vendin dhe kohën e testimeve;
- c) T'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohe të arsyeshme në vendin ku do të realizohen testimet.

19.4 Nëse përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues nuk është prezent në datën e vendosur për testim, furnizuesi mundet që, përveç nëse ka marrë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, të vazhdojë testimin, i cili do të konsiderohet se është bërë në prezencën e autoritetit kontraktues. Furnizuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikuar si duhet të rezultateve të

testit të Autoritetit kontraktues, nëse nuk ka qenë prezent gjatë testit, do t'i pranojë rezultatet e testit.

19.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet e sipërpërmendura, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë furnizuesin ose ta miratojë certifikimin e furnizuesit lidhur me këtë.

19.6 Nëse autoriteti kontraktues dhe Furnizues nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do t'ia japë tjetrit mendimin e vet brenda 15 ditësh nga mospajtimi i tillë. Autoriteti kontraktues ose Furnizues mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, të testohen nga një ekspert i zgjedhur me marrëveshje të ndërsjellë. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues, i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të furnizuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e së cilës dëshmohej se është gabim pas ri-testimit.

19.7 Gjatë realizimit të detyrave të tyre, autoriteti kontraktues dhe personat e autorizuar nga ai nuk do t'i shpalojnë personave të paautorizuar informata lidhur me metodat e ndërmarrjes së prodhimit dhe operimit, të cilat informata i kanë marrë gjatë inspektimit dhe testimit.

Neni 20 Parimet të përgjithshme të pagesave

20.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i bëhet Furnizues sipas kësaj Kontrate do të specifikohen në KVK.

20.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Furnizues do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Furnizuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

20.3 Shumat duhet të paguhesh brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

20.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Furnizuesin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Furnizues do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

20.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 20.3, Furnizues mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga institucioni lëshues i Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

20.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 20.3 do t'i japin të drejtë Furnizuesit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

Neni 21 Dorëzimi

21.1 Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të jenë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.

21.2 Furnizuesi do t'i paketojë furnizimet ashtu siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin apo keqësimin e gjendjes së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet të jetë i mjaftueshëm për të përballuar pa kufizime, bartjen e ashpër, ekspozimin në temperatura ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhe mbajtjen në ambient të hapur. Madhësia e paketimit dhe pesha duhet t'i përshtaten, nëse është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të furnizimeve, dhe mundësisë së mungesës së pajisjeve për bartje të rëndë në të gjitha pikat gjatë transitit.

21.3 Paketimi, shënimi dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet të jenë në pajtim me kërkesat e dhëna në mënyrë të hapur në KVK, dhe i nënshtrohen ndryshimeve që mund të urdhërohen më vonë nga autoriteti kontraktues.

21.4 Asnjë furnizim nuk do të transportohet as të dorëzohet në vendin e pranimit derisa furnizuesi të ketë pranuar urdhrin e dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Furnizuesi do të jetë përgjegjës për dorëzim në vendin e pranimit të të gjitha furnizimeve dhe pajisjeve të furnizuesit, që janë të nevojshme për qëllime të kontratës.

21.5 Dorëzimi duhet të konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion për të dy palët se dorëzimi i furnizimeve është bërë në pajtim me kushtet e kontratës.

Neni 22 Operacionet e verifikimit

22.1 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.

22.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të furnizimeve dhe para se të merren furnizimet, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:

- a) heqjen nga vendi i pranimit, brenda asaj kohe ose kohësh siç është specifikuar në urdhër, të të gjitha furnizimeve të cilat, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, nuk janë në pajtim me kontratën;
- b) zëvendësimin e tyre me furnizime të mira dhe të përshtatshme;
- c) heqjen dhe ri-instalimin e mirë të pajisjeve, pa marrë parasysh testet e mëparshme të tyre ose pagesat e pjeshme të tyre, ose ndonjë instalim që lidhet me materialet, mjeshtërinë ose dizajnin për të cilin është përgjegjës furnizuesi, e që sipas mendimit të autoritetit kontraktues nuk është në pajtim me kontratën;
- d) që puna e bërë ose mallrat e dorëzuara apo materialet e përdorura nga furnizuesi janë ose nuk janë në pajtim me kontratën, ose që furnizimet apo një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e kontratës.

22.3 Furnizuesi, sa më shpejt që është e mundur dhe me shpenzime të veta, duhet t'i evitojë defektet e specifikuar. Nëse Furnizuesi nuk vepron sipas këtyre urdhrave, Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të punësojë persona tjerë për t'i zbatuar urdhrat dhe të gjitha shpenzimet që janë pasojë e kësaj, apo që do të shfaqen për shkak të kësaj, Autoriteti kontraktues do t'i zbrësë nga paratë që do të paguhen ose të cilat do të bëhen obligim për t'iu paguar Furnizuesit.

22.4 Furnizimet që nuk janë të cilësisë së kërkuar do të refuzohen. Një shenjë speciale mund t'u vendoset furnizimeve të refuzuara. Shenja nuk duhet të jetë e atillë që t'i ndryshojë ato, apo të ndikojë në vlerën e tyre komerciale. Furnizimet e refuzuara furnizuesi do t'i heqë nga vendi i pranimit, nëse këtë e kërkon autoriteti kontraktues, brenda një periudhe që e saktëson autoriteti kontraktues, dhe nëse kjo nuk realizohet ato do të hiqen me të drejtë me shpenzim dhe me rrezik të furnizuesit. Të gjitha punët që përfshijnë materialet e refuzuara do të refuzohen.

Neni 23 Pranimi i përkohshëm

23.1 Furnizimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të jenë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuara, dhe të jenë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimit të përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar.

23.2 Furnizuesi mund të bëjë kërkesë, duke lajmëruar autoritetin kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm atëherë kur furnizimet të jenë të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga pranimi i aplikacionit të furnizuesit do të veprojë sipas njëres nga këto më poshtë:

- t'i lëshojë furnizuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar furnizimet në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose

- të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsytet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij e kërkon Furnizuesi për ta lëshuar certifikatën.

23.3 Nëse rrethanat e jashtëzakonshme e bëjnë të pamundur që të vazhdohet me pranimin e furnizimeve gjatë periudhës së fiksuar për pranim të përkohshëm ose final, autoriteti kontraktues e përgatit një deklaratë për ta vërtetuar pamundësinë e tillë, nëse është e mundur, në konsultim me furnizuesin. Certifikata e pranimit ose e refuzimit do të përgatitet brenda 30 ditësh pas datës në të cilën kjo pamundësi pushon së ekzistuari. Furnizuesi nuk do të nxisë shfaqjen e këtyre rrethanave për të evituar obligimin e paraqitjes së furnizimeve në një gjendje të përshtatshme për pranim.

23.4 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej [30] ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe, përveç në rastet kur certifikata e pranimit të përkohshëm konsiderohet se përbën certifikatë të pranimit përfundimtar. Nëse furnizimet ndahen me kontratë në pjesë, Furnizuesi do të ketë të drejtë të bëjë kërkesë për certifikatë të veçantë për secilën pjesë.

23.5 Në raste të dorëzimit të pjesshëm, Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën për të dhënë pranim të pjesshëm e të përkohshëm.

23.6 Pas pranimit të përkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkthazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 24 Obligimet për garanci

24.1 Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Furnizuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në KVK.

24.2 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:

- a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshtërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Furnizuesi; ose
- b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Furnizuesit gjatë periudhës së garancisë; ose
- c) shfaqen gjatë ndonjë inspektimi të bërë nga Autoriteti kontraktues ose në emër të tij.

24.3 Furnizuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet. Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë

ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. periudha e garancisë do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.

24.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë k Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të parapara në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të korrigjojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhet ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit ose nga të dy;
- b) në rast se nuk ka sasi të duhur ose asnjë garanci nuk është efektive kërkoni që të merrni shumën e duhur nga Furnizuesi; ose
- c) të ndërpresë kontratën.

24.5 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në KVK dhe në specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 25 Shërbimet pas-shitjes

25.1 Shërbimet pas-shitjes, nëse kërkohen në kontratë, do të jepen në pajtim me të dhënat e parapara në KVK. Furnizuesi do të marrë përsipër të realizojë ose të organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe të riparimit të furnizimeve dhe të sigurojë shpejt pjesët rezervë. KVK mund të saktësojnë që Furnizuesi të sigurojë ndonjë ose të gjitha materialet e mëposhtme, njoftimet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Furnizuesi:

- a) pjesët rezervë të cilat Autoriteti kontraktues mund të vendosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës
- b) në rast të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve rezervë, duhet të lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues për t'i mundësuar që të blejë pjesët e kërkuara dhe, pas ndërprerjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nëse kërkohen dhe kur kërkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

Neni 26 Pranimit përfundimtar

26.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Furnizuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 24 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

26.2 Kontrata nuk do të konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit ose derisa të konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

26.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Neni 27 Shkelja e kontratës

27.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

27.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

27.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

27.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Furnizuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 28 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

28.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur Furnizuesi në mënyrë përmbytëse nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;

- b) Furnizuesi dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
- c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjisllacionin apo në rregulloret nacionale;
- f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjete të cilin mund ta vërtetojë Autoriteti kontraktues;
- h) Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;
- i) Furnizuesi, pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;
- j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

28.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përmbushjen duhet të pushojë së ekzistuari menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të jenë paraqitur tashmë.

28.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

28.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë rexhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Furnizuesit dhe parave që i ka borxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

28.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të jenë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

28.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

Neni 29 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

29.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.
- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

29.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

29.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 29.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

Neni 30 Forca madhore

30.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi

i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

30.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

30.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 16 dhe 28, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 20.5 dhe 29, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

30.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues.

30.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhrave të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 30.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

Neni 31 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

31.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 32 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

32.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA



Numri i kontratës: 624-26-4629-5-5-8/C1378





KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.






[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]




Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	Furnizim me inventar per Komunë dhe Shkolla me numër identifikues: 624-26-4629-5-5-8 & 624-26-35-558
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit do të caktohet me vendim të ZKA-se pasë nënshkrimit të kontratës
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është: 7,000.00 euro 10 % e vlerës së parashikuar për një periudhë prej 7 muaj.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: a) Mjetet motorike të Palës së Tretë 100 % të OE b) Përgjegjësia e palës së tretë 100% të OE c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve 100% d) Përgjegjësia profesionale 100% e OE <i>[shëno shumen]</i> e) Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve 100% OE
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues do të behen nga menaxheri i kontratës.
Dorëzimi	21.3	Furnizuesi do t'i bartë të gjitha rreziqet që kanë të bëjnë me mallrat deri në pranimin në destinacion. Furnizimet duhet të paketohen në mënyrë që të parandalohet dëmtimi i tyre deri në destinacionin e tyre.
Obligimet e garancionit	22.1	Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit .
Shërbimet pas shitjes	23.1	Vlera e furnizimit të kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit..
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	24.2	Zyra e prokurimit Komuna Suharekë
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	25.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.



Furnizim me inventar për Komunë dhe Shkollë - Suharekë


Nr	Pershkrimi Teknik i produkteve	Foto-ja	Njësia	Sasia	çmimi
01	1.1 Tavoline pune – e cila duhet te jete e punuar nga MDF me trashësi minimumi 36 mm me metodë speciale. Struktura e këmbëve duhet te jete nga metali 40x20 mm me profile te formuara si kuti 15x15 mm me strumbulla te veçanta të aluminit. Këmbët te lyera me elektrostاتيke me pluhur, duhet te ketë dy-tri floka me sistem te hapjes ne shtytje, dhe te ketë sistemin e kalimit të kabllave elektrike. Dimensionet 260x90x75cm 1.2 Komodë anësore – e cila duhet te jete e punuar nga materiali i njëjte sikurse tavolina. Dimensionet – 100x50x66cm. 1.3 Komodë me dyer – e cila duhet te jete e punuar nga materiali i njëjte sikurse tavolina. Dimensionet – 200x50x75cm. 1.4 Tavoline e ulet për pritje/mes – e punuar nga materiali i njëjte sikurse tavolina me trashësi 12mm, Struktura e këmbëve duhet te jete nga metali 40x20 mm me profile te formuara si kuti 15x15 mm me strumbulla te veçanta të aluminit. Këmbët te lyera me elektrostاتيke me pluhur. Dimensionet – 80x50x27cm		Copë	1	685
02	2.1 Tavoline pune e punuar nga melamine me trashësi minimum 36 mm, te ketë një pjese përmbi të punuar me MDF me trashësi min. 18 mm, Pllaka e përparme e kombinuar e dy paneleve me trashësi 18 mm dhe minimum 30 mm. Të ketë kanal plastik per kalimin e kabllave. Dimensionet – 260x90x75 cm. 2.2 Anësore për tavoline e cila duhet te jete e te njëjtë model, material sikur se tavolina, duhet te ketë një shtator me tri floka me sistemin e hapjes me shtytje. Dimensionet – 140x55x61 cm. 2.3 Tavoline e ulet për pritje/mes – e cila duhet te jete e te njëjtë model, material sikurse tavolina. Dimensionet – 80x50x42 cm.		Copë	1	395
03	Tavoline pune nga e punuar nga melamine me trashësi ne pjesen e sipërme min. 30 mm ndersa pjesa e këmbëve dhe pjesa përpara me trashësi min.18mm. Ndërsa brinjët e pllakës të mveshura me shirit ABS me trashësi d= 2 mm. Tavolina duhet të ketë vrimë per depërtim te kabllave elektrike. Dimensionet 180x70x73.5cm				218
04	Tavoline pune nga e punuar nga melamine me trashësi ne pjesen e sipërme min. 30 mm ndersa pjesa e këmbëve dhe pjesa përpara me trashësi min.18mm. Ndërsa brinjët e pllakës të mveshura me shirit ABS me trashësi d= 2 mm. Tavolina duhet të ketë vrimë per depërtim te kabllave elektrike. Dimensionet 160x70x73.5cm		Copë	1	185




05	Tavoline pune nga e punuar nga melamine me trashësi ne pjesen e sipërme min. 30 mm ndersa pjesa e këmbëve dhe pjesa përpara me trashësi min,18mm. Ndërsa brinjët e pllakës të mvëshura me shirit ABS me trashësi d= 2 mm. Tavolina duhet të ketë vrimë per depërtim te kablllove elektrike. Dimenzionet 140x70x73.5cm		Copë	1	185
06	Tavoline pune nga e punuar nga melamine me trashësi ne pjesen e sipërme min. 30 mm ndersa pjesa e këmbëve dhe pjesa përpara me trashësi min,18mm. Ndërsa brinjët e pllakës të mvëshura me shirit ABS me trashësi d= 2 mm. Tavolina duhet të ketë vrimë per depërtim te kablllove elektrike. Dimenzionet 120x70x73.5cm		Copë	1	185
07	Tavoline për takime e punuar nga Melamine i laminuar min. 36 mm dhe i lyer me lak apo matt, pjesa e elektrifikimit duhet te vij nga mesi dhe te lidhet me pjesën e sipërme, këmbët dhe mbajtëset e tavolinës duhet të jenë të punuara në mënyrë special nga melamine , pjesa e sipërme duhet te jete e fiksuar mir dhe të siguroj qendrueshmëri. Tavolina gjysmë rrethore ose drejtkëndëshe varet nga kërkesa e AK Dimenzionet 260x120x73		Copë	1	470
08	Tavoline për takime e punuar nga Melamine i laminuar min. 36 mm dhe i lyer me lak apo matt, pjesa e elektrifikimit duhet te vij nga mesi dhe te lidhet me pjesën e sipërme, këmbët dhe mbajtëset e tavolinës duhet të jenë të punuara në mënyrë special nga melamine , pjesa e sipërme duhet te jete e fiksuar mir dhe të siguroj qendrueshmëri. Tavolina gjysmë rrethore ose drejtkëndëshe varet nga kërkesa e AK Dimenzionet 220x100x73		Copë	1	430
09	Tavoline për takime e punuar nga Melamine i laminuar min. 36 mm dhe i lyer me lak apo matt, pjesa e elektrifikimit duhet te vij nga mesi dhe te lidhet me pjesën e sipërme, këmbët dhe mbajtëset e tavolinës duhet të jenë të punuara në mënyrë special nga melamine , pjesa e sipërme duhet te jete e fiksuar mir dhe të siguroj qendrueshmëri. Tavolina gjysmë rrethore ose drejtkëndëshe varet nga kërkesa e AK Dimenzionet 180x90x73		Copë	1	370
10	Prodhim, furnizim, transporti dhe montimi i Tavolinës së takimit me karakteristikat teknike si ne vijim: Dimensione: diameter 110cm x73cm Material: Iver Panel Teksturë: Peryel i mbyllet, e bardhe mat, elma dhe arrë (teksturen e perzgjedh organi mbikqyres) Trashësi: 3.6cm		Copë	1	180


11	Tavoline për takime për 4 persona - 120x120x74 e cila duhet të punohet nga kompakt melamine min. 36 mm. Struktura/këmbët duhet të jënë të punuara nga metali i infektuar të cilat janë të lidhura me profile, dhe duhet të jënë të lyera me pluhur elektrostatik, këmbët duhet të jenë të fiksuara mirë që të sigurojnë qendrueshmëri.		Copë	1	225
12	Dollap i cili duhet të jetë e punuar nga melamine ku pjesa e sipërme duhet të jetë min. 30 mm ndërsa ndarjet min.18mm, duhet të ketë dy ndarje horizontale dhe vertikale, të ketë mekanizmin e mbylljes pa zhurmë, xhamat të jenë të thejshëm apo të zalluar varet nga kërkesa e AK me profil të aluminit rrëshqitës. Dimensionet - 160x45x110 cm		Copë	1	288
13	Dollap i cili duhet të jetë i punuar nga melamine ku pjesa e sipërme dhe ndarjet duhet të jenë min. 30 mm, ndërsa dyer 18mm rrëshqitëse, duhet të ketë dy ndarje horizontale dhe vertikale, të ketë mekanizmin e mbylljes pa zhurmë. Dimensionet - 160x45x110cm		Copë	1	248
14	Dollap i hapur i cili duhet të jetë i punuar nga melamine, ku pjesa e sipërme duhet të jetë min. 30 mm, duhet të ketë pesë ndarje horizontale. Dimensionet - 80x42x190cm		Copë	1	107
15	Dollap me dyer xhami i cili duhet të jetë e punuar nga melamine me ku pjesa e sipërme duhet të jetë min. 30 mm, ndërsa dyert me xham të thejshëm apo të zalluar të rrethuar me alumini, duhet të ketë pesë ndarje horizontale. Dimensionet - 80x42x190 cm		Copë	1	198
16	Vitrinë e mbyllur, me çelës në njerën dorë, me dimensione (80 x 40 x 200cm), e punuar nga pllake zdrutkthi melamine treshitresore, ngjyra e përzgjedhur nga autoriteti kontraktues, me trashes d=18 mm, ndërsa brinjët e pllakes të mveshura me shirit ABS me trashesi d= 2 mm, me rreze r=2mm, në pjesën e brendshme pesë hapësira për dosje, ndërsa në dyer të vendosen doreza kualitative të kromuara.		Copë	1	185
17	Vitrinë e mbyllur, në pjesën e sipërme e hapur, me çelës në njerën dorë, me dimensione (80 x 40 x 200cm), e punuar nga pllake zdrutkthi melamine treshitresore, ngjyra e përzgjedhur nga autoriteti kontraktues, me trashes d=18 mm, ndërsa brinjët e pllakes të mveshura me shirit ABS me trashesi d= 2 mm, me rreze r=2mm, në pjesën e brendshme tre hapësira për dosje, ndërsa në dyer të vendosen doreza kualitative të kromuara.		Copë	1	177

18	Kasetë levizëse me tri fioka ; fioka e parë me mbyllje , me system te mbylljes pa zhurm, ku pjesa e sipërme duhet te jete min. 30 mm ndersa pjeset tjera me min,18mm. Ndersa brinjët e pllakes te mveshura me shirit ABS me trashesi d=1 mm ose furnir i integruar. Dimenzioni 45x55x59 cm		Copë	1	89
19	Furnizimi, transporti ,punimi dhe montimi i elementeve (dollar,garderob, rafte, tavolina dhe te ngjashme sipas kërkeses se AK) me MDF të fisnikruar me dimension të trashesise t=18mm me ngjyre te percaktuar nga Organi Mbikqyrës. Ne kuader te ketij pozicioni duhet te perfshihen te gjithë aksesoret e nevojshem si mbajtësit metalik, dorezat metalike, mekanizmat, amortizuesit me rastin e mbylljes etj. Tekstura percaktohet nga organi përgjegjës i autoritetit kontraktues.Masat duhet te merren ne vend.Menteshat (bagllamët) të përdoren nga brendet me kualitet të lartë sic janë BLUM, Hettich apo të ndonjë prodhues tjetër ekuivalent me kualitete të njejt. Pozicioni gjithashtu përfshin të gjithë materialin shpenzues deri në lëshuarjen në funksion dhe të jetë në gjendje plotësisht funksionale, pozicioni te punohet sipas kërkesave te AK.	 	m 2	1	487,5
20	Furnizimi, transporti ,punimi dhe montimi i elementeve (dollar,garderob, rafte, tavolina dhe te ngjashme sipas kërkeses se AK) me Iverpillakë të fisnikruar me dimension të trashesise t=18mm me ngjyre te percaktuar nga Organi Mbikqyrës. Ne kuader te ketij pozicioni duhet te perfshihen te gjithë aksesoret e nevojshem si mbajtësit metalik, dorezat metalike, mekanizmat, amortizuesit me rastin e mbylljes etj. Tekstura percaktohet nga organi përgjegjës i autoritetit kontraktues.Masat duhet te merren ne vend.Menteshat (bagllamët) të përdoren nga brendet me kualitet të lartë sic janë BLUM, Hettich apo të ndonjë prodhues tjetër ekuivalent me kualitete të njejt. Pozicioni gjithashtu përfshin të gjithë materialin shpenzues deri në lëshuarjen në funksion dhe të jetë në gjendje plotësisht funksionale, pozicioni te punohet sipas kërkesave te AK.	 	m 2	1	347,5
21	Prodhimat, furnizimi, transporti dhe montimi i Dollapit me karakteristika teknike si ne vijim: Dimensione: 120cm x 40cm x 85cm Material: Iver Panel Teksturë: Poryel i mbyllet, e bardhe mat, efma dhe arrë (teksturen e perzgjedh organi mbikqyrës) Trashësi: 18mm		Copë	1	98




22	Prodhimë, furnizimi, transporti dhe montimi i Dollapit me karakteristikat teknike si në vijim: Dimensione: 80cm x 40cm x 85cm Material: Iver Panel Teksturë: Peryel i mbyllet, e bardhë mat, elna dhe arrë (teksturen e perzgjedh organi mbikqyres) Trashësi: 18mm		Copë	1	80
23	Furnizimi, transporti, punimi dhe montimi i divan ulëseve sipas kërkeses së AK, nga materiali : sfungjer, dru i fortë, dru i shtresuar, poliestër, dru gome; Ulësja - Sfungjer, dru i fortë, dru i shtresuar, poliestër, Mbështetësja: Sfungjer, dru i fortë, dru i shtresuar, poliestër, Mbështetësja për duar: Sfungjer, dru i shtresuar, poliestër, Këmbëza: plastike ose metal; Mbështetësja Pëlhura: Poliestër apo lekur, Materiali i sfungjerit: Sfungjer polieteri, Dendësia e sfungjerit: 20/40 kg/m³; Mbështetësja për duar Pëlhura: Poliestër, Materiali i sfungjerit: Sfungjer polieteri, Dendësia e sfungjerit: 20/40 kg/m³. Përmasa standarte të ulëseve , të jenë të rehatshme dhe komode për qendrën ditor. Ngjyra: vendos AK		m 1	1	287
24	Ulëse Materiali Sfungjer, MDF, metal, poliestër Materiali Ulësja: Sfungjer, MDF, poliestër, Mbështetësja: Sfungjer, MDF, poliestër, Këmbëza: Metal Ulësja Pëlhura: Poliestër, sfungjer Materiali: Sfungjer poliuretani, Densiteti i sfungjerit: 24 kg/m³ mbështetësja Pëlhura: Poliestër, Materiali i sfungjerit: Sfungjer poliuretani trajtimi Ngjyrë e pjekur Mbushja Ulësja dhe mbështetësja me sfungjer Ngjyra Gjellbër ulliri, Zezë tipari Kadife Dimensionet: Gjerësia: 50 cm, Lartësia: 87 cm, thellësia: 59 cm Lartësia e ulëses 51 thellësia e ulëses 46 Ngarkesa maksimale 110 kg Modeli sipas fotos.		Copë	1	29
25	Karrigen nga materiali Ulësja: Lëkurë artificiale (PU/poliuretani), sfungjer, PP (polipropilen), mbështetësja: PP (polipropilen), këmbëza: Metal Trajtimi Ngjyrë e pjekur ulësja: Mbushje me sfungjer ngjyra Bardhë Dimensionet: Gjerësia: 49 cm, Lartësia: 87 cm, thellësia: 54 cm Lartësia e ulëses 49 thellësia e ulëses 42 Modeli sipas fotos.		Copë	1	39
26	Karrige për sallën e takimeve. Materiali: pjesa e uljes dhe mbështetjes të jetë nga lëkurë artificiale e kualitetit të lartë, që mirëmbahet lehtë. Struktura e karrigës të jetë nga metali anti korrodes dhe pjesa e mbështetjes së krahëve të jetë e mbështjellur me të njëjtin material si pjesa e uljes dhe mbështetjes. Modeli sipas fotos ose e ngjashme.		Copë	1	87

27	Karrigë pune (Furnizimi, blerja dhe montimi) Materiali: krom, lëkurë artificiale, sfungjer, metal anti korrodes, Polipropilen, dru i shtresuar, rrethë poliesteri. Ngjyra: e zezë/antracid/gjelbërt ulliri Funksioni: rrota me lërkim me mundësi rrotullimi 360°, lartësi e rregullueshme dhe baza të jetë nga metali. Dimensionet: Gjerësia: 63cm; Lartësia: 109-119cm; Thellësia: 61cm; Lartësia e ulës: 45-55 cm; Thellësia e ulës: 49cm. Duhet të prezantohen së paku 5 modele ku njëra do të përcaktohet nga organi mbikqyrës. Modeli duhet të jetë sipas në fotos.		Copë	1	85
28	Furnizimi, transporti dhe montimi. Karrige ekzekutive lëvizëse me mbështetëse të lartë Karrigeja duhet të jetë me dimensione të përgjithshme 71-74cm x 74-76cm x 116-126cm, duhet të jetë nga materiali i lekur, shpuzë, drushtresuar, çelik, duhet të jetë aftës të përballojë peshë të madhe dhe rezistencë të madhe ndaj çdo lloji tensioni, duhet të jetë përforcim të brendshëm me shpuz të butë për një komoditet, mbështetëse shumë e lartë me shtresë të pasur me materiale shkurme, mbështetëse kralesh të rehatshme të mbushur shpuz, e veshur me lëkurë me cilësi të lartë me teknikë të qepur, me bazë dhe me këmbë të lakura me rrota, bazë metalike, me mekanizëm të animit dhe lartësi të rregullueshme.		Copë	1	188
29	Furnizimi, transporti dhe montimi i karrige lëvizëse, Karriga duhet të jetë me dimensione sipas skices. Trupi i karriges Rrjetë pëlhurë me mbështetëse për Mesin, kornizë shpine PA+GF, shkurme e prerë me dendësi 30, mbështetëse koke e rregullueshme, mbështetëse mesit e rregullueshme, mbështetëse krahu e rregullueshme PU, rrota najloni të zeza 60R, bazi najloni 345 mm, ngritje me gaz 100 mm klasa-4, mekanizëm pjesë flutur, 3 pozicione kyçjeje, dërrasë druri 1.4 cm (pa mbulesë sediljeje). Karrigeja duhet të jetë e njëjtë, identike sipas specifikacionit, karakteristikave, dimensioneve dhe fotografive e skicimeve të bashkangjitur dhe të ketë mundësi për të ngjyruar sipas kërkes së AK. Karrigeja duhet të jetë e përshtatshme për qëndrim ditor të gjatë të personelit, të sigurojë qëndrueshmëri dhe të bartë peshë deri 120kg.		Copë	1	388,5

	 	 				
30	Furnizimi, transporti dhe montimi Furnizimi me karrike statike Dimensioi 47-49-51CM Karrika statike me U me kromi profil me dorza te kromir te mbeshitjellura me slitofe te te zi dhe pjesen larte me vjete . Duhet te prezantohen se paku 5 modele ku njera do te përzaktohet nga organi mbikqyrës. Modeli duhet te jetë sipas në fotos.		Copë	1		95,5


31	Furnizimi, transporti dhe montimi i karrige statike me këmbë metali, Karriga duhet të jetë me dimensione: gjatësia nga toka 80cm, gjerësia 54cm, thellësia 47cm, Karriga duhet të ofrohet me material shkume polyetene me densitet prej 28dms i mbështjellur me lëkurë densitet 600gr për m2 mundësi prosie prej 3 ngjyra, me martindale në rezistencë prej minimum 22,000, Këmbët e karriges duhet të jenë nga metali i ngjyrosur me metodë elektrostatische, forma e metalit të 4 këmbëve duhet të jetë në formë të rrumbullakët me diametër prej 2cm .Pesha totale e karriges duhet të jetë jo më pak se 11kg, Karrigeja duhet të jetë e njëjtë, identike sipas specifikacionit, karakteristikave, dimensioneve dhe fotografive e skicimeve të bashkangjitura. Pesha e karriges duhet të jetë jo më pak se 11kg, të sigurojë qëndrueshmëri dhe të bartë peshtë deri 120kg, dhe të ketë mundësi prosie të ngjyrave sipas kërkes së AK.		Copë	1	127,5
32	Furnizimi, Transporti, dhe Montimi karrige statike duhet të jetë me dimensione 44cm x 44cm x 44cm / 75cm, karrigeja duhet të jetë e punuar nga konstruksioni i tubave të metalit në form elipse me dimension 30mm x 15mm x 1.0mm, dhe të ngjyrosur nga ngjyra krom , vrimat e tubave dhe këndet e konstruksionit duhet të jetë e mbuduara me plastika. Ulsja dhe mbështetja e karriges duhet të jetë e punuar nga plastika e investur me shpuzë të kallupuar dhe me slot të thurur, dhe e mbuluar nga kapaku i plastikes ne pjesen e pasme.		Copë	1	49,5
33	Karrige Lëvizëse Ergonomike , Dimensionet e ulësës së Karriges pa përshirë dorëzat duhet të jetë gjerësia 50cm, thellësia 47cm, Shpina e karriges duhet të jetë me kornizë plastike përreth dhe me rrejtë me mundësi zgjedhje minimum 3 ngjyra, dimensionet e shpinës gjerësia 46cm, gjatësia 60cm, Ulsësja e karriges duhet të jetë nga shkume polireteni me mbështjellje me material mikrofiber me densitet 200gr për m2, me mundësi zgjedhje të ngjyrës, me rezistencë të martindales prej minimum 45,000, Pjesa e shpinës për shkak të fortësisë duhet të ketë shtyllë metali të ngjyrosur me metodë elektrostatische ngjyrë e zezë e cila ngjitet nga baza e Karriges e deri në krye të shpinës, Dorëzat duhet të jenë nga plastika e zezë në formë T me mundësi ngritje poshtë lartë për të mundësuar mbajtjen e duarve në pozicione të ndryshme, Karriga duhet të ketë mekanizmin për rregullimi sinkronik të mbështetëses për të mundësuar shfrytëzuesit qëndrim sa më komod, Karriga duhet të ketë mekanizmin për mbështetje të lumbarit me lëvizje poshtë-lartë 10cm, Karriga duhet të ketë nivelin 4 të paslufit , Karriga duhet të ofrohet me yll kromi pesë këmbë me diametër prej 65 cm dhe me rrota 65mm, Karrigeja duhet të jetë e njëjtë, identike sipas specifikacionit, karakteristikave, dimensioneve dhe fotografive e skicimeve të bashkangjitura, pesha totale e karriges duhet të jetë jo më pak se 20kg , Karriga duhet të ketë mbështetëse të kokës me mundësi lëvizje		Copë	1	488,5

triangle me dimensione gjerësia 27cm lartësia 15cm. Karrigeja duhet të jetë e përshtatshme për qëndrim ditë të gjatë të personelit, të sigurojë qëndrueshmëri dhe të bartë pesë deri 120kg, dhe të ketë mundësi proshe të ngjyave sipas kërkes së AK.



34




Banka për nxenes të nivelit klasor prej 1-5 me dimensione 60x120x63cm, banka duhet të jetë e punuar nga konstruksionit i tubave të metalit në formë me dimension 40mm x 30mm x 2mm, dhe duhet të jetë e ngjyrosur nga ngjyra elektrostاتيke, vrimat e tubave dhe këndet e konstruksionit duhet të jetë të mbuluara me plastika. Pjesa e poshtme e mbastave të librave duhet të jetë e punuar nga lloj paneli, ndërsa pllaka e sipërme e bankës duhet të jetë e punuar nga lloj paneli 18mm.






Copë 1

88,4

35	Banka per nxenes te nivelit klasor prej 6-9 me dimensione 60x120x70cm, banka duhet te jetë e punuar nga konstruksioni i tubave të metalit në form me dimension 40mm x 30mm x 2mm, dhe duhet të jetë e ngjyrosur nga ngjyra elektrostاتيke, vrimat e tubave dhe këndet e konstruksionit duhet të jetë të mbuluara me plastika. Pjesa e poshtme e mbajtëse të librave duhet të jetë e punuar nga treer paneli, ndërsa pllaka e sipërme e bankës duhet të jetë e punuar nga treer paneli 18mm.		Copë	1	93,5
36	Banka per nxenes te nivelit klasor prej 10-12 me dimensione 60x120x75cm, banka duhet te jetë e punuar nga konstruksioni i tubave të metalit në form me dimension 40mm x 30mm x 2mm, dhe duhet të jetë e ngjyrosur nga ngjyra elektrostاتيke, vrimat e tubave dhe këndet e konstruksionit duhet të jetë të mbuluara me plastika. Pjesa e poshtme e mbajtëse të librave duhet të jetë e punuar nga treer paneli, ndërsa pllaka e sipërme e bankës duhet të jetë e punuar nga treer paneli 18mm.		Copë	1	98,8
37	Karrige per nxenes te nivelit klasor prej 1-5 me dimensione 37x37x40/75cm, karriga duhet te jetë e punuar nga konstruksioni i tubave të metalit 40mm x 30mm x 2mm, dhe duhet të jetë e ngjyrosur nga ngjyra elektrostاتيke, vrimat e tubave dhe këndet e konstruksionit duhet të jenë të mbuluara me plastika. Ullësja dhe mbështetësa duhet të jenë të punuara nga pllaka kompensato nga fletet e rimësos së drurit të alut me trashësi 8mm.		Copë	1	48,5
38	Karrige per nxenes te nivelit klasor prej 6-9 me dimensione 40x40x42/75cm, karriga duhet te jetë e punuar nga konstruksioni i tubave të metalit 40mm x 30mm x 2mm, dhe duhet të jetë e ngjyrosur nga ngjyra elektrostاتيke, vrimat e tubave dhe këndet e konstruksionit duhet të jenë të mbuluara me plastika. Ullësja dhe mbështetësa duhet të jenë të punuara nga pllaka kompensato nga fletet e rimësos së drurit të alut me trashësi 8mm.		Copë	1	55,4
39	Karrige per nxenes te nivelit klasor prej 6-9 me dimensione 40x40x44/75cm, karriga duhet te jetë e punuar nga konstruksioni i tubave të metalit 40mm x 30mm x 2mm, dhe duhet të jetë e ngjyrosur nga ngjyra elektrostاتيke, vrimat e tubave dhe këndet e konstruksionit duhet të jenë të mbuluara me plastika. Ullësja dhe mbështetësa duhet të jenë të punuara nga pllaka kompensato nga fletet e rimësos së drurit të alut me trashësi 8mm.		Copë	1	65,8
40	Karrige për fëmijë e ciklit parafillor e cila duhet te jetë e nderuar nga konstruksioni iu alu solid i ngjyrosur me ngjyr vaji e pershtatshme per fëmij, këmbët e karriges duhet të jenë cilindrike dhe me dimension Ø32mm, të jetë e forcuar tek pjesa e këmbëve me profile cilindrike ne seciten pjesë me dimension prej Ø20mm. Lartësia e ulës nga toka është 310mm, karrige me dimensione standarte 325mm x 325mm dhe lartësi 600mm h. Pjesa e ulës është nga material i butë shpuzë rreth 2cm dhe e mbuluar me shuf që është rezistent nda ujit dhe qe pastrohet lehtë ndërsa pjesa e mbështetëses ka vetëm një element me dimension prej 7cm dhe të jetë nga druri alu solid i ngjyrosur. Modeli sipas fotos dhe ngjyrat sipas kërkeses AK.		Copë	1	68,5

41	Tabela shkrimi (shkolllore), me dimensione (120cm x 240cm) nga MDF i presur dhe i plastifikuar, me foli ngjyrë të gjelbër, e përshdaltshme për shkrim. Tabela duhet ta ketë kornizën nga alumini profil U, mbajtesën për shpizë. Trashësia e tabelës d=1.8cm.		Copë	1	128,6
42	Dërrasë muri me shtrese te bute (tapet), si ne foto, me trashësi mbi 1.8cm, me dimensione 120x90cm.		Copë	1	38,6
43	Dollap Metalik per fildem pjesa posht me dyer nga metali ndersa pjesa sipër me dyer te xhamit. Dim. 1800*950*390mm. 1. Nënshtresa: E bërë nga pllakë çeliku e mbështjellë me cilësi të lartë, 2. Trashësia:0.6mm, dyert sipër te punohet nga një korniz form drejtkëndshme me llanarine 0.6mm dhe te ket hapsire qper xham me trashesi 3mm 3. Aksesorë harduerikë: Doreza është një lloj kombinimi i shtrëngimit të fshehur, i bërë nga aliazh alumini, i bukur dhe i qëndrueshëm; Të gjithë aksesorët harduerikë trajtohen me parandalimin e ndryshkut dhe korrozionit, duke përmbyshur standardet kombëtare. 4. Procesi: Saldim me frekuencë të lartë, me sipërfaqe saldimit uniforme dhe konsistente, pa spërkatje, shkretje, Saldim Profesional, depërtimi saldimit dhe dukuri të tjera.		Copë	1	238
44	Dollap metalik me 2 dyer me dim 1800*900*420 mm 1. Nënshtresa: E bërë nga pllakë çeliku e mbështjellë me cilësi të lartë, 2. Trashësia:0.6mm, secila nga dyert te ken 2 qelsa 3. Aksesorë harduerikë: Doreza është një lloj kombinimi i shtrëngimit të fshehur, i bërë nga aliazh alumini, i bukur dhe i qëndrueshëm; Të gjithë aksesorët harduerikë trajtohen me parandalimin e ndryshkut dhe korrozionit, duke përmbyshur standardet kombëtare. 4. Procesi: Saldim me frekuencë të lartë, me sipërfaqe saldimit uniforme dhe konsistente, pa spërkatje, shkretje, Saldim Profesional, depërtimi saldimit dhe dukuri të tjera. E bërë prej çeliku të mbështjellë të fortë me cilësi të lartë, përmbyshur ujin, rezistent ndaj lagështirës dhe kundër zjarrit, i lehtë për tu pastruar dhe mirëmbajtur. Ideale për zyrë apo edhe në salla te arsimitarve Hapësirë e bollshme për ruajtjen e rrobave dhe sendeve të tjera personale të sigurt. Në mes të çdo grile ka një ndarje, e cila ndahet në dy shtresa. Shtresa e poshtme mund të përdoret për këpucë, etj. Me një kënd hapjeje prej 130° dhe 2 çelësa, kapaciteti maksimal i ngarkesës për raft: 10 kg	 	Copë	1	268
45	Dollap Metalik per personel me 12 dyer me dim. 1850*900*350mm. 1. Nënshtresa: E bërë nga pllakë çeliku e mbështjellë me cilësi të lartë, 2. Trashësia:0.6mm, secila nga dyert te ken 2 qelsa 3. Aksesorë harduerikë: Doreza është një lloj kombinimi i shtrëngimit të fshehur, i bërë nga aliazh alumini, i bukur dhe i qëndrueshëm; Të gjithë aksesorët harduerikë trajtohen me parandalimin e ndryshkut dhe korrozionit, duke përmbyshur standardet kombëtare. 4. Procesi: Saldim me frekuencë të lartë, me sipërfaqe saldimit uniforme dhe konsistente, pa spërkatje, shkretje, Saldim Profesional, depërtimi saldimit dhe dukuri të tjera. E bukur dhe bujare, e ndritshme dhe e sheshtë, pa grimca, fluska ose njolla skorje në sipërfaqe dhe ngjyrë uniforme; Sipërfaqja e kabinetit ka avantazhe të		Copë	1	478

	ulla si rezistenca ndaj presionit, forcë e lartë, e papërshkueshme nga uji, kundër ndotjes, rezistent ndaj goditjes, jo deformueshmëri, rezistente ndaj lagështirës dhe kundër korrozionit.				
46	Furnizimi me tepison, me dizajne te ndryshem me ngjyra dhe me lodra, duhet te jetë përvese është rezistente ndaj papastërtive, yndyrës dhe papastërtive, është gjithashtu rezistente ndaj lagështirës, mykut dhe aromave. duhet të ketë veti të mira akustike të jetë antimikrobike dhe shumë e qëndrueshme por edhe e butë. Ngjillet me ngjites special dy komponentesh në një bazë- sferiaqe paraprakisht të trajtuar dhe të rrafshët. Nuk duhet të përmbajne kimikate të dëmshme, të janë natyrale, dhe rezistente ndaj djegies, nxehtësisë.		m 2	1	38,5
47	Furnizimi, Transporti, Punimi dhe Montimi i Perde Shiritore Vertikale me lartësi min. 120- max. 250 cm, për zyre nga materiali polyester që pastrohen lehtë me ujë. Ngjyra të përcaktohet nga organi mbikqyrës. Të parashihen të gjitha pajisjet e nevojshme për montim dhe funksionalizim te perdes. Prodhuesi duhet ti respektoj të gjitha normat teknike Europiane Pozicioni gjithashtu përfshin të gjithë materialin shpenzues deri në lëshuarjen në funksion dhe të jetë në gjendje plotësisht funksionale.		m 2	1	57,8
48	Furnizimi, Transporti, Punimi dhe Montimi i Perdeve -Roletneve të kualitet të lartë për zyre në pjesën e brendshme të dritareve. Në çnim të llogaritet edhe furnizimi dhe montimi i mekanizmit mbajtës të këtyre perdeve roletneve. Llojin e materialit dhe ngjyrën e përcakton Organi Mbikqyrës, së pari sjellet katalogu dhe pas aprovimit, vazhdohet me furnizim dhe montim, (sipas skicës). Prodhuesi duhet ti respektoj të gjitha normat teknike Europiane. Pozicioni gjithashtu përfshin të gjithë materialin shpenzues deri në lëshuarjen në funksion.		m 2	1	55,7
49	Varëse druri për rroba Varëse druri rrobash duhet të jetë me dimensione standarte eshte nga materiali Dru hangu natyral dhe e vajosur me ngjyr druri, pjesa e poshtme duhet të jetë nga tapa plastike apo kembeza per mbrojtjen e ambientit dhe dyshemes.		Copë	1	88,5
50	Tavolini e vogël (furnizimi, blerja dhe montimi) Forma Kretshore Materiali Pjesa e sipërme: MDE, Ngjyra: teksture lisi Këmbëzat: Çelik. Ngjyra: Zezë Dimensinet: Diametri: 55 cm, Lartësia: 45 cm Statusi i montimit Vetë montim Pesha 3 kg Modeli sipas fotos		Copë	1	49,5
					9.489,40